

Marrëveshjen e bashkepunimit e Federatës së Shoqatave Shqiptare FNAI dhe Federatës së Shoqatave Arbëreshe FAA

Me nder e kenaqesi po raportoj "Marreveshjen e bashkepunimit" midis Federates se Shoqatave Shqiptare FNAI dhe Federates se Shoqatave Arbereshe FAA.

Me ftese te Federates se shoqatave Shqiptare ne Itali, ne daten 14 Prill ne Breshia u takuan ; Presidenti i Federates se Shoqatave te komunitetit Arberesh ne Itali, Z. Damiano Guagliardi dhe Presidentja e Federates te Shoqatave Shqiptare ne Itali, Znj. Anila Cenolli.

Takimi u zhvillua ne nje nga sallat e vena ne dispozicion nga Komuna e Gardones ne Brescia. Presidenti i Faa-it , u shoqerua nga Prof. Antonio Alfio Moccia dhe nga artisti i njohur, piktori e skulptori i talentuar Z. Hevzi Nuhiu.

Nga pala e Federates se Shoqatave shqiptare merrnin pjese anetaret e keshillit drejtues si vijon; Z. Erio Korani, sekretar i Fnai-it

Znj. Erida Cela Perlala, nje nga aktivistet dhe themelueset e para te Fnai-it .

Dott.ssa Anisa Karagjozi, Financiere e Federates.

Z. Granit Mucaj, Sekretar i Shoqates "Skanderbeg" – Fermo.

Z. Skender Lazaj, President i "Lidhjes se shkrimtareve dhe artisteve shqiptare ne Itali".

Z. Ardit Aliaj, President i Organizates vullnetare " Interaction"

Z. Sherif Nuredini dhe Astrit Hyska, nga Shoqata Shqiptonja, Bergamo- Brescia.

Aktivistet Znj. Vojsava Basha dhe Z. Nexhmi Mati.

Ndermjet te tjerave ne kete marreveshje u la hapesia e bashkepunimit me institucionet vendase dhe atyre te vendit te origjines per nje angazhim konkret ne promovimet e perbashketa per barazi dhe te drejta te plota ne sferat e jetes politike , kulturore dhe sociale.

Ne takim u shpreh entuziazmi i njohjes se veprimtarise te komunitetit arberesh, ruajtjes se gjuhes dhe traditave kombetare ne shekuj.

Dëshira për të njohur nga afër vëllezërit arbereshe ne shkëmbimin e përvojave përkatëse në punën e bërë në interes të komunitetit eshte shume domethenese per te gjithë ne, si dhe per arritjet e objektive te Federates.

Nuk mund te kete per ne shqiptaret e emigracionit te viteve te fundit, eksperience me domethenese se ajo e vellezerve tane arbereshe.

Ky takim, i pari i këtij lloji , ka një rëndësi të veçantë dhe i hap rrugën një bashkëpunimi të nevojshëm e te frytshëm midis dy federatave dhe më gjerë midis aktivisteve te ketyre organizatave. Kjo do të bëjë që diaspora të jete edhe më aktive në jetën e vendit tonë, duke shtruar probleme e kërkesa, por edhe duke dhënë ndihma siç është bërë, me investime, ndihma humanitare etj. Ka ardhur momenti te behemi dhe prezantohemi si force e madhe, aktive dhe e domosdoshme perpara





istitucioneve tona ne menyre qe ky kontribut te thellohet dhe strukturohet ne menyre zyrtare. Ne kete drejtim nje ndihme e madhe vjen nga manifestimet kulturore dhe artistike , te cilat kane nje rol te vecante ne ruajtjen dhe trazmetimin e traditave tona brezave te ardhshem, por edhe ne kerkimin e te drejtave te emigranteve shqiptare.

Ne menyre konkrete lidhur me këtë nga të dy presidentët e Federatave u nënshkrua edhe një marrëveshje bashkëpunimi.

Qellimi i ketij Protokolli bashkepunimi u krye ne kuader te intensifikimit te raporteve midis federatave per shkembim eksperiencash, programe mbi ecurine e shkollave shqipe dhe te drejtave te individeve.

Nje falenderim te vecante Zotit Damiano Guagliardi per disponibilitetin dhe pasurine shpirterore e profesionale ne dispozicionin e komunitetit shqipetar.

Me respekt Presidentja e Federates Fnai

Znj. Anila Cenolli / 26 prill 2019, publikuar ne Faqen FB: **FNAI**